



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 06 qershor 2019, në mbledhjen e XII-të (dymbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11:05.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Valbona Kadriu Podvorica Zëvendës kryesuese e Komitetit, *(deri në pikën të ndryshme nga e cila mori kryesimin znj. Albina Avdiu e zgjedhur Kryesuese e Komitetit për Komunitete).*

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, Albina Avdiu, Mefail Rama, Bashkim Sylja, ndërsa mungoi, Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Bashkim Bajrami nga Policia Kufitare, Fadil Babatinca nga Stacioni Policor në Podujevë, Skender Shatri përfaqësues i OSBE-së, dy përfaqësues të KFOR – LMT, si dhe Ekrem Merovci nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Vushtrisë.

Rendi i ditës

znj. Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i njoftuar rreth pikave të rendit të dhe shtoi, nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

z. Mefail Rama, theksoi, kam dy propozime për përfshirje në rend të ditës, dhe atë:

-Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete, dhe

-Situata e një banoreje të komunitetit rom për të cilën sigurisht jeni në dijeni të gjithë sepse është përfol në media dhe ka pasur incidente në disa qytete, andaj meqë ajo femër është banore Komunës së Podujevës do të ishte mirë të diskutohet dhe të jepen disa informata rreth saj në pikën Të ndryshme, ngase kemi një situatë paksa të ndërlikuar dhe që na ka prek të gjithë pothuajse.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës, duke përfshirë edhe pikat shtesë të propozuara nga parafolësi, përkatësisht:

- në pikën 5 hynë pika Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete, ndërsa

- pika Të ndryshme kalon në pikën 6 në të cilën ndër të tjera hynë për diskutim çështja / situata e krijuar rreth një banoreje të Komunitetit Rom.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 07.05.2019

Njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05.04.2019

2. Identifikimi i mundësive për punësim sezonal të pjesëmarrësve të Komunitetit Rom, Ashkalinj dhe Egjiptas, organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Departamenti i Agjencionit të Pyjeve të Kosovës në bashkëpunim me Entin e Punësimit – zyra për Punësim.

z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK, përshëndeti të pranishmit dhe falënderoj për pjesëmarrje z.Ekrem Merovcin nga Vushtrria, Koordinator për kthim të qëndrueshëm, ndër të tjera theksoi, punësimi dhe mirëqenia sociale është një temë e cila kërkon një elaborim pak më të thellë. Jemi në dijeni se po jetojmë në një gjendje jo të mirë ekonomike, pa punësim, pa zhvillim, nganjëherë e them se nuk ka as perspektivë për rini, dhe si shkas i këtyre gjërave, dhe duhet ta pranojmë që nuk e kemi marrë seriozisht rininë, punësimin, zhvillimin ekonomik e që si shkak i kësaj po ndodh edhe migrimi i cili ndoshta në mënyrë të heshtur po na preokupon, temë me të cilën është duke u marrë edhe qeveria qendrore, edhe kjo lokale por edhe ne si individ sepse vërtetë është shqetësim i kësaj e të rinjve nga vendi, temë e cila natyrisht që prek edhe komunitetin jo shumicë. Kur rinia kryejnë universitete, dhe shkollime të ndryshme, kërkojnë punë, e që kemi një rini që na e kanë lakminë edhe Evropa, ndërsa ne nuk jemi të zotët t’iu krijojmë vende pune dhe t’i stabilizojmë atëherë natyrisht që secili kërkon fatin e vetë dhe një jetë më të mirë, por kjo mbetet breng për të gjithë, andaj edhe kemi paraparë si temë sepse është në interes dhe ka të bëjë me punësimin dhe mirëqenien sociale.

Jemi në dijeni se komunitetit jo shumicë nuk është i anashkaluar në këtë aspekt sepse të njëjtat gjëra/kritere vlejnë edhe për komunitetin shumicë, por me theks të veçantë tek ai jo shumicë punësimi është jashtëzakonisht i vogël numerikisht dhe në bazë të të dhënave që ne i kemi në vitin 2018 kanë qenë 25 persona të punësuar në gjithë sektorët e ndryshëm, qoftë të nivelit qendror qoftë lokal. Ne për çdo vit kemi pas një bashkëpunim të mirë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale - MPMS, Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - MBPZHR, me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, dhe në këtë aspekt është shumë normale që ambienti ka një rol të veçantë për të cilin ka edhe donacione të ndryshme nga jashtë por edhe nga brenda, dhe në kuadër të kësaj për çdo vit ka edhe punësime sezonale dhe në këtë aspekt ne si ZKKK në bashkëpunim me Entin e punësimit dhe me MPMS, dhe me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, dhe duke marrë parasysh që punëtorët e sezonal merren me mbrojtjen e ambientit, pastrimin e pyjeve, lumenjve, ambientit, hapësirave, dhe mandati i tyre është 3 deri në 6 muaj, dhe në kuadër të kësaj në vitin e kaluar kanë qenë 50 të punësuar ku 8 prej tyre kanë qenë nga komuniteti jo shumicë. Edhe tani jemi në kontakte me institucionet e cekura dhe kemi kërkuar që në kuadër të mundësive t’iu jepet mundësi më e madhe Komunitetit jo shumicë, pavarësisht se nuk është punësim afatgjatë dhe nuk janë pagat e larta, por duke qenë në dijeni për gjendje të rëndë që kanë qoftë ekonomike qoftë sociale.

Enti i punësimit mban evidenca, por natyrisht që gjithëherë nuk mund të jenë të sakta sepse ato evoluojnë, në vitin e kaluar kemi pas 84 persona të regjistruar si punë kërkuar, prej tyre 82 të komunitetit ashkalinj dhe 2 rom, por normal që duke u bazuar në kriteret përkatës, e që jemi në dijeni se shumë familje të komuniteteve jo shumicë kanë edhe ndihma sociale, mirëpo ata kërkojnë punë por që nuk gjejnë dhe në këtë aspekt rregullojnë dokumentacionet në mënyrë që ta kenë një ndihmë sociale. Duke u bazuar në të dhënat e Qendrës për Punë Sociale, në asistencë sociale janë

68 familje të komunitetit RAE, 66 ashkalinj me 426 anëtarë dhe 2 nga rom me 15 anëtar, dhe nëse shikojmë në kuptimin demografik del që 441 anëtarë të komuniteteve RAE janë në asistencë sociale, kurse numri i atyre që kanë kërkuar punë është 84 në vitin 2018, por tani nuk dihet numri i saktë sepse mund të kemi ngritje - rënie ngase çdo 3 muaj duhet të lajmërohen në zyrën përkatëse. Duke u bazuar në këto rrethana që jemi, dhe në mundësitë që kemi qoftë si Komunë, qoftë OJQ-të, qoftë organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare, çdo herë kemi pasë në theks të veçantë punësimin me qëllim të një mirëqenie më të mirë për të gjithë banorët, me theks edhe për komunitetin jo shumicë, që sado pak të zbutet papunësia që është element paksa i ndjeshëm, çështje për të cilës gjithherë kemi qenë në kooperim me të gjitha institucionet përkatëse, por megjithatë nuk mund të themi se jemi të kënaqur sepse kuptohet që kërkesat janë shumë të mëdha, çështje të cilën po e shohim të gjithë çdo ditë dhe që është temë me të cilën duhet një elaborim më i thellë por janë organet dhe institucionet përkatëse që ndoshta duhet të merren më shumë.

Pra nuk po e zgjati më shumë këtë temë sepse ndoshta mund të ketë pyetje dhe sqarime nga pjesëmarrësit, por si temë është e nevojshme të trajtohet dhe të jepen informata sepse tani është edhe sezoni kur ka punësime sezonale andaj është mirë që këtë ta kemi parasysh që mundësisht t'ju japim përparësi edhe ne si Komitet për Komunitete edhe ZKKK, atyre njerëzve që kanë më shumë nevojë për punësim.

znj.Albina Avdiu, theksoi, ndoshta edhe jeni të informuar që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me institucionet relevante ka hapur konkurs për praktikantë sezonal me kohëzgjatje 6 muaj plus 6 muaj, andaj sa jam në dijeni në Komunën e Podujevës janë punësuar dy persona nga komuniteti jo shumicë, por nuk e di janë në kuadër të atij projekti të Ministrisë apo jo. Natyrisht duke kërkuar që të ketë punësime më të mëdha të personave të komunitetit jo shumicë, përndryshe edhe OJQ – Voice RAE ka hapur konkurs për praktikant të ri deri në 3 muaj, me pagesë për student dhe të rinjtë e komuniteteve jo shumicë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, përgjigje parafolëses, theksoi, është e vërtetë që janë dy praktikant nga komuniteti jo shumicë dhe është mirë që është aplikuar kjo formë që më përpara nuk ka qenë me pagesë. Po ashtu është mirë që këtë barrë e ka marrë përsipër MPMS e që mendoj se do të ketë edhe ngritje në këtë aspekt qoftë për praktikantë qoftë për studentë të rinjë që do të ishte një avancim i madh. Në fakt punëtorë sezonal janë më shumë ata që merren me ambientin dhe pyjet kurse praktikant me pagesë është çështje tjetër dhe është mirë që këtë hap e ka marrë Ministria të cilën e kam mirëpritur dhe këtë jua kam thënë edhe në takime që kemi pasë me përfaqësues të Ministrisë.

T'ju them të drejtën nëse e kemi orientimin në Evropë, atëherë në Evropë çdo praktikant paguhet, dhe kjo është dashtë të aplikohet ndoshta edhe më herët tek ne sepse nuk është mirë që nëse një praktikant bënë praktikë 3 apo deri në 6 muaj dhe nuk paguhet të paktën sa për shpenzime e bëra.

z.Bashkim Sylja, theksoi, kam dy pyetje të shkurtra, u tha nga parafolësi që në vitin e kaluar kanë qenë të punësuar 8 persona nga komuniteti RAE, andaj pyetja është, a ka mundësi që në këtë vit që jemi të shtohet numri i të punësuarve nga komuniteti RAE.

Pyetja tjetër ka të bëjë me procedurat dhe kriteret e të punësuarve në fjalë, andaj a ka rregulla të cila e rregullojnë këtë çështje, shembull të mos jenë dy të punësuar nga një familje etj të ngjashme.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, përgjigje parafolësit, theksoi, në fakt unë e ceka se me çështjen e punësimit merret zyra për punësim dhe kur iu referova numrit 84 e thash që është si statistikë dhe ata i kanë të gjitha informacionet për secilin andaj në këtë kuptim mendoj se edhe çështjen e punësimit të personave nga e njëjta familje e kanë të rregulluar, por në bazë të kërkesave konkurrojnë persona të ndryshëm, gjë kjo e cila ndodh edhe për komunitetin shumicë.

Ne gjithherë kemi kontakte me zyrën për punësim dhe çdo herë kemi kërkuar t'iu jepet hapësirë më e madhe komunitetit jo shumicë. Kjo për arsye se mund të jenë ndoshta mbi njëmijë perona që konkurrojnë duke përfshirë edhe ata të komunitetit shumicë, dhe nëse i referohemi krahasimit statistikor atëherë ndoshta mund të del 20 – 30 fish më i madh, mirëpo ne kemi kërkuar me theks të veçantë që t'iu jepet përparësi peronave të Komunitetit jo shumicë që të paktën të kemi zbutje të papunësisë edhe për ato komunitete. Mirëpo zyra e punësimit janë në dijeni edhe për gjendjen sociale të familjeve / peronave të komunitetit jo shumicë sepse kanë bashkëpunim me QPS-në dhe shkëmbejnë informata mes vete lidhur me familjet që kanë më shumë nevojë për punësim.

znj.Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, falënderoj parafolësit për informatat dhe kontributin e dhënë rreth kësaj pike.

3. Shqyrtimi i mundësive për organizimin e kurseve për pjesëtarët e Komunitetit RAE, të cilët mund të kenë vështirësi eventuale në shkrim – lexim.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, rreth kësaj teme vazhdimisht e kam cekë që mundësia më e mirë e socializimit është arsimimi sa më i lartë i secilit komunitet, andaj në këtë kontekst është shumë i nevojshëm organizim i kurseve të tilla, por do të ishte mirë të organizoheshin edhe kurse për prindërit që ata të ndikojnë tek fëmijët e tyre për arsimim sa më shumë të jetë e mundur sepse siç jemi në dijeni është një numër shumë i vogël i nxënësve të komunitetit jo shumicë të cilët vazhdojnë shkollimin pas klasës nëntë. E them këtë sepse nëse vazhdojmë vetëm me ndihma për këtë komunitet nuk është zgjidhje afatgjate sepse me arsimim mbeten mbrapa pastaj.

z.Bashkim Sylja, theksoi, pajtoj me atë që parafolësja e potencoj, mirëpo mendoj që caktimi i lokacioneve është mirë të organizohet në ato pjesë ku ata jetojnë sepse jemi në dijeni se kryesisht familjet e komunitetit jo shumicë jetojnë në tri lokacione, andaj do të ishte mirë që kurse të tilla të organizoheshin në shkollat më të afërta të atyre tri lokacioneve. Kur kemi parasysh që më 28 qershor përfundon viti shkollor, është mirë që Drejtoria e Arsimit të përfshihet në këtë proces.

E them këtë sepse kur organizohen kurse, duhet të caktohen edhe mësimdhënësit, edhe pagesat, edhe lokacionet etj, pastaj gjatë pushimit mund të paraqiten edhe pengesa sepse mund të mos gjenden të lirë. Pra mendimi im është që ndoshta do të ishte më mirë që kurse të tilla të organizohen në muajin shtator dhe në ato shkolla ku ata banorë banojnë. Mandej nuk ceket as mosha e atyre që do të vijojnë kurset, andaj është mirë të sqarohemi rreth kësaj çështje.

z.Mefail Rama, theksoi, sa i përket çështjes së arsimimit për peronat e komunitetit jo shumicë është shumë e mirëseardhur çdo iniciativë, mirëpo fillimisht do të ishte mirë të bëhej identifikimi dhe numri i personave që do të vijojnë kursin. Në këtë proces mendoj se do të ishte mirë të përfshihej edhe Drejtoria e Arsimit, përndryshe një projekt i tillë është shumë i mirëseardhur, dhe ne do të bëjmë përpjekje të identifikojmë personat që kanë interesim për pjesëmarrje në kurs, dhe bashkërisht t'i dorëzojmë listat në Drejtorinë e Arsimit.

Gjithashtu do të ishte e mirëseardhur edhe organizimi i mësimit shtesë për nxënësit e komunitetit RAE, dhe në këtë aspekt mendoj që Drejtoria e Arsimit mund të merr veprime konkrete, natyrisht bashkërisht me neve si Komitet dhe me një kooperim të ngushtë me organizata të ndryshme dhe me akterët tjerë relevant.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit, mendoj se Drejtoria e Arsimit është më shumë e thirrur për këtë çështje. Pajtoj me z.Bashkim Sylën ngase këto çështje i kemi diskutuar edhe në vitet e kaluara në bazë të asaj që ka qenë një thirrje e

përgjithshme që analfabetizmi të çrrënjohet në një mënyrë. Ne veç e dimë që nga komunitetit jo shumicë duke mos përjashtuar edhe atë shumicë ka ende persona që nuk dinë shkrim lexim.

Pajtoj plotësisht që të bëhet identifikimi i atyre që kanë nevojë dhe interesim për kurse të tilla arsimore ashtu sikurse që pajtoj që tani janë pushimet verore në arsim, mirëpo mundësisht në bashkëpunim me ju dhe me të gjitha organet tjera të mundohemi të gjejmë hapësirë dhe mundësi që t'iu mundësohet të gjithë atyre që kanë interesim, të vijojnë kursin. Normal që Drejtoria e Arsimit e ka buxhetin e ndarë për çështje të tilla, trajnime, kurse etj, andaj do të ishte mirë të angazhohemi të gjithë. Pavarësisht që nuk është e përcaktuar mosha për këto kurse, është fakt që shumica e atyre që nuk dinë shkrim lexim kanë dëshirë të mësojnë një gjë të tillë, dhe në këtë aspekt më së shumti mund të luajnë rol edhe anëtarët e Komitetit për Komunitete nga radhët e komunitetit jo shumicë. Pra është mirë që u diskutua kjo temë në mënyrë që të jemi të përgatitur në muajin shtator kur edhe fillon viti i ri shkollorë. Pra lokacionet besoj se ekzistojnë dhe janë të favorshëm për komunitetet ku jetojnë sepse janë afër me banim, qoftë në Orllan, qoftë afër shkollës "DR Ibrahim Rugova" qoftë edhe ata të lagjes "Ali Ajeti", dhe kjo vlen për të gjitha komunitetet sepse nuk mund të bëhen dallime, dhe në këtë aspekt unë kam biseduar me Drejtorinë e Arsimit edhe në të kaluarën e që Drejtoria është e përgatitur dhe ka përvojë në këtë proces.

znj. Albina Avdiu, theksoi, ndoshta paksa po dal jashtë temës, mirëpo kur ishte fjala rreth kursit për arsim dua të pyes z.Liman Zeqirin, nëse ekziston mundësia që të organizohet edhe një kurs vetëdijësues rreth martesave të hershme të komunitetet jo shumicë, përkatësisht tek vajzat e reja në mënyrë që të informohen sa më shumë rreth pasojave dhe gjithçka tjetër që sjellin martesat e hershme për vajzat e reja në veçanti. Andaj konsideroj se edhe kjo temë ndërlidhet me arsimin sepse ndoshta për faktin që ka martesa të hershme ka edhe braktisje të shkollimit, dukuri kjo e cila është e shfaqur edhe tek komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës, prandaj do të ishte mirë të organizohen kurse vetëdijësuese edhe për këtë temë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, është e vërtetë që tema të cilën e ngriti parafolësja është mjaft e ndjeshme, madje për këtë kemi mbajtur edhe tryeza, takime dhe tubime të ndryshme, dhe në këtë aspekt edhe në kuadër të Planit të Veprimit për Integrimin e Komunitetit RAE është një pikë e veçantë, përkatësisht, martesat e hershme, nëse i referohemi kësaj teme dhe Qendrës për Punës Sociale, shkaktarë ndoshta është paksa edhe çështja ekonomike – sociale dhe ato vajza ose ata djem martohen në moshë të re me qëllim të arritjes së një ndihme sociale dhe në mënyrë që t'iu shmangen ndoshta disa obligimeve të martesës, e them këtë ngase përgatitja e martesës kërkon kosto dhe kohë, të jemi të sinqertë, dhe tani normal që martesat e papërgatitura kanë edhe pasojat e veta, dhe pastaj ndodh të ketë edhe prindër të atillë që nuk kanë aftësi të plotë prindëror.

Pra rreth kësaj çështje është mirë ndoshta të bëhet edhe një informim më i gjerë ngase siç e ceka mund të ndodh që të ketë martesa edhe për shkak të ndihmave që iu bëhen sepse ka mendime që për shkak të kushteve të rënda dhe humbjes së shpresës për një vend pune dhe për perspektiv për të ardhmen martohen herët dhe fitojnë ndihma apo hynë në asistencë. Pra me qëllim të vetëdijësimit të popullatës, me theks të komuniteteve jo shumicë ne mund ta kemi këtë temë në një prej mbledhjeve të radhës apo edhe ta organizojmë një tryezë përmes organizatave që merren me ndërgjegjësimin ose vetëdijësimin, dhe të ketë pjesëmarrës në numër të madh qoftë edhe të prindërve së bashku me fëmijët e tyre.

znj.Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit, falënderoj parafolësit për diskutimet rreth pikës përkatëse.

4. Caktimi i datave për vizita Komuniteteve në territorin e Komunës së Podujevës

znj.Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit, theksoi, paraprakisht kemi biseduar rreth datës së vizitave në fjalë, dhe kemi ardhur në përfundim që data 24 qershor 2019 është e konvencueshme për të gjithë që të bëjmë vizitat e planifikuara e që besoj se do të mund të mbërrijmë t'i vizitojmë gjitha lagjet ku jetojnë Komunitetet jo shumicë, andaj a pajtoheni me këtë datë.

Njëzëri u pajtuan vizita Komuniteteve jo shumicë të bëhet më 24 qershor 2019, nga ora 10:00 në lagjen e cila është në rr. "Xhafer Meta" dhe në lagjen në rr. "Ali Ajeti".

5. Zgjedhja e Kryesuesit/es të Komitetit për Komunitete

znj.Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit, theksoi, konsideroj se të gjithë jemi në dijeni për shkaqet përse Komiteti për Komunitete aktualisht është pa Kryesues, prandaj kjo pikë hyri si pikë shtesë e rendit të ditës që është propozim i z.Mefail Rama, përfaqësues i njërit prej komunitetit jo shumicë. Jeni në dijeni se në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete duhet të zgjedhet njëri prej anëtarëve të komitetit që është nga komuniteti jo shumicë, andaj urdhëroni mund të paraqitni emrat e propozuar ku secili nga anëtarët mund të propozoj një emër, pastaj zgjedhja bëhet me shumicë të votave të anëtarëve.

z.Mefail Rama, theksoi, në emër të komunitetit jo shumicë të përfaqësuar në këtë Komunitet, propozoj znj.Albina Avdiu për Kryesuese të Komitetit për Komunitete.

znj.Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ka ndonjë propozim tjetër, nëse jo atëherë e vëmë në votim propozimin që znj.Albina Avdiu të jetë Kryesuese.

Konstatim

Pas votimit u konstatua se njëzëri nga anëtarët/et e Komitetit për Komunitete, znj.Albina Avdiu, zgjedhet Kryesuese e Komitetit për Komunitete në Komunën e Podujevës, me mandat të njëjtë të Komitetit.

znj.Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit, uron Kryesuesen e sapo zgjedhur dhe i dëshiron punë të mbarë dhe suksese në të ardhmen, njëkohësisht fton që ta merr kryesimin e mbledhjes.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e sapo zgjedhur e Komitetit, theksoi, në cilësinë e Kryesueses së Komitetit për Komunitete, ju falënderoj të gjithëve për besimin e dhënë që unë të zgjedhem në këtë detyrë e cila ndoshta nuk është privilegj por është një obligim shtesë për mua.

Shpresoj dhe do të bëjë përpjekje maksimale për një bashkëpunim sa të mirë me të gjithë, pa dallime sa i përket punëve dhe detyrave që kemi si Komitet për Komunitete. Pa humbur kohë mund të vazhdojmë me punë sipas pikës me radhë.

6. Të ndryshme

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e sapo zgjedhur e Komitetit, në këtë pikë ndër të tjera, fillimisht kemi të lajmëruar qysh në fillim të mbledhjes se z. Mefail Rama dëshiron të paraqet një informatë rreth situatës që ka të bëjë me një banorë të Komunitetit Rom e cila këtyre ditëve është bërë temë në media dhe ka pasur disa situata të pakëndshme, andaj fjalën ja jap anëtarit të cekur.

z. Mefail Rama, theksoi, ju informoj se Policia e Republikës së Kosovës – Stacioni i Policisë në Podujevë më ka kontaktuar më 30 maj 2019 kur ka ndodh një ngjarje një femre të komunitetit rom e cila ka qenë e sulmuar fizikisht në qytetin e Ferizajt dhe një ose dy ditë pas ka qenë e sulmuar në qytetin e Lipjanit. Kjo femër e cila është kthyer në vitin 2014 nga Belgjika, dhe është mbajtur, sa kam informata rreth 2 javë nga Ministria e Punëve të Brendshme në një strehim riatdhesimi në Prishtinë, pas 2 javëve më kanë kontaktuar mua personalisht dhe jam shkuar në atë shtëpi ku ka qenë e strehuar dhe e kam gjetur te dera me valixhe në dorë. Sigurisht që Ministria nuk ka pas mundësi ta mbaj më tutje atë femër në atë shtëpi strehimi, dhe personi përgjegjës që ka qenë ka kërkuar nga unë që të nënshkruaj një dokument dhe ajo femër të sjellët në Podujevë. Pastaj unë e kam sjellë atë femër në Podujevë e cili ka qëndruar në shtëpinë që është thënë se është pronë e saj, përkatësisht në afërsi të tjegullores. Pastaj së bashku me atë femër kemi qenë në Komunë ku kemi dërguar kërkesa në të gjitha Drejtoritë e Komunës së Podujevës me theks në atë të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pastaj edhe në Zyrën e Riatdhesimit ku zyrtar është Ylber Salihu, kërkesa të cilat kanë qenë kryesisht për shërbime rreth dokumentacionit të shërbimit civil, pastaj ai person në vitin 2014 në një formë ka protestuar para KFOR-it dhe ka kërkuar ndihmë personale për sigurimin e strehimit dhe banimit, mirëpo nuk e di arsyen por përgjigjet nuk janë kthyer pozitivisht nga ana e Komunës.

Mandej siç e ceka, më 30 maj 2019 mua më ka kontaktuar Policia dhe më ka thënë se jeni i përgjegjshëm si anëtar i Komitetit për Komunitete që ta merrni përgjegjësinë që atë femër ta strehoni në territorin e Komunës së Podujevës. Unë kam dhënë një deklaratë dhe kam thënë se ne si anëtar të Komitetit për Komunitete dhe si përfaqësues i komunitetit rom, nuk mund ta marrim përgjegjësinë për një gjë të tillë sepse nuk jemi ekzekutiv i Komunës dhe nuk kemi mundësi ta zgjedhim problemin e strehimit dhe banimit, mirëpo mund të japim një kontribut human.

Nga disa media dhe në rrjete sociale është shpërndarë lajmi që ajo femër ka bërë këtë ka bërë atë, por në bazë të asaj që unë jam i informuar ajo femër ka rënë viktimë, dhe lidhur me këtë shteti është i obliguar për mbrojtjen e personave që janë të pambrojtur siç ka qenë ajo femër e cila në dytri raste ka qenë duke ecur në rrugë e që ka mund të ndodh diçka edhe më keqe.

Tani sa jam i informuar ajo femër gjendet në një shtëpi e strehuar dhe e siguruar apo të themi është në mbrojtje nga institucionet përgjegjëse të shtetit, dhe presim në të ardhmen që atij personi t'i behet zgjidhje afatgjate. Pra kjo është vetëm një informatë që unë deshta të jap.

z. Liman Zeqiri, shëf i ZKKK, theksoi, informata rreth këtij rasti kemi marrë edhe nga mediat dhe jemi në dijeni se personi në fjalë që është riatdhesuar, ka qenë edhe me disa anëtar të familjes së saj. Është familje e cila ka ardhur nga Belgjika dhe në atë kohë unë në bashkëpunim me zyrtarin për integritet evropiane ju kemi ndihmuar asaj familje sa i përket rregullimit të dokumentacionit kryesisht atij civil. Faktikisht prona ku ka jetuar ajo familje, që është në afërsi të tjegullores, në rr. "Skenderbeu" është paksa problematike sepse siç thuhet ajo pronë është shitur, madje kemi edhe personin përkatës që ka deklaruar se ai e ka blerë atë pronë. Prandaj kur kemi të bëjmë me problematika të tilla që kanë të bëjnë me prona dhe nuk mund të gjejmë strehim, ata persona kanë migruar në Obiliq, sa jam në dijeni unë. Mandej unë kam pas kontakte edhe me zyrën e ZKKK të Komunës së Obiliqit, por që e gjithë problematika ka qenë strehimi dhe prona.

Rreth pronës në fjalë, a është shituar, si është shitur dhe si është tjetërsuar, është çështje tjetër dhe nuk kam informata, mirëpo në dokumentacione përkatëse, ajo pronë nuk qëndron në emër të asaj femre, dhe këtë mund ta verifikojmë shumë lehtë në kadastër.

Është fakt që shteti ka për obligim të mbrojtë personat. Si akte që kanë ndodhur me atë person e kemi dënuar, qoftë si Komunë, qoftë si media, institucione qendrore dhe lokale, pra është dënues akti që i ka ndodh asaj femre, madje një akt të tillë e quaj dhe e cilësoj të shëmtuar.

Po ashtu edhe nga këtu si Komiteti për Komunitete e dënojmë rastin e sulmeve fizike që kanë ndodh në dy apo tri qytetet ndaj femrës në fjalë.

Nëse një individ mund të ketë qasje aq negative siç është proklamuar në disa media dhe në rrjete sociale, janë organet e shteti ato të cilat duhet të ndërmarrin masa, por askush nuk ka të drejtë që t'ia cenoj dikujt të drejtën e lëvizjes së lirë, të banimit apo edhe të strehimit.

Pra është mirë që u dhanë këto informata në këtë mbledhje. Unë edhe kur është kthyer ajo familje nga Belgjika kam qenë i informuar me këto gjëra, sa jam në dijeni ajo familje ka probleme edhe gjuhë sepse nuk e njohin ngase kanë qëndruar një kohë të gjatë në Belgjikë, pra komunikojnë vetëm në gjuhën angleze dhe në gjuhën belge. Është edhe fakti që ajo familje një kohë të gjatë nuk kanë qëndruar në Podujevë, por kanë lëvizur në qendra tjera, në Lipjan, Fushë Kosovë, Obiliq.

Ne sa i përket dokumentacioneve civile etj, jua kemi rregulluar në fakt ju kemi ndihmuar në rregullimin e tyre që është edhe obligim i yni, me gjithë problemet që kemi hasur sepse nuk ka pas as dokumentacione të sakta por është dashtë që përmes arkiva të QKMF-së etj. Pra i them këto sepse jam marrë shumë me këtë familje, por problem kryesor ka qenë prona.

Prandaj si akt besoj që të gjithë jemi njëzëri që e dënojmë, sepse është gjë e shëmtuar, është e pa drejtë, dhe nuk bënë të përsëriten më gjëra të tilla, kurse asaj femre i dëshirojmë të gjitha të mirat, kur kemi parasysh që shteti ka marrë në mbrojtje tani më.

z.Fadil Babatinca, nga Stacioni i Policisë në Podujevë, theksoi, unë vetëm mund të them se femra në fjalë tani është në trajtim nga Qendra për Punës Sociale, ne kemi asistuar në këtë trajtim, dhe për momentin ai person është i strehuar në strehimore. Se çfarë do të ndodhë më tutje janë institucionet dhe organet tjera përkatëse që do të merren me këtë rast.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e sapo zgjedhur e Komitetit, theksoi, patëm informacione të nevojshme sa i përket rastit që i ka ndodh para disa ditëve një femre të komunitetit rom, rast për të cilin besoj se jemi në dijeni të gjithë.

është mirë që nga ne të gjithë si Komitet u dënua një akt i tillë dhe shpresoj që tani të jetë zgjidhur problemi i asaj femre, të cilës i dëshirojmë rahat dhe urojmë t'i mos i ndodh më asgjë.

Jemi mirënjohës ndaj institucioneve dhe organeve tjera të shtetit që kanë ndërmarrë veprime konkrete dhe kanë marrë në mbrojtje atë femër, dhe shpresojmë se do t'i bëhet zgjidhje afatgjate.

Nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën urdhëroni, nëse jo e kontattojme të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55'

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0045102/19
Podujevë,
06 qershor 2019

zv.Kryesuese e Komitetit
Valbona Kadriu-Podvorica

Kryesuese e Komitetit
Albina Avdiu